REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

**KOMUNA E GJAKOVËS**
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

**Kuvendi i Komunës së Gjakovës**
**01 Nr.463/01 - 33031 /2018**
**Dt. 04.12.2018**

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 20 paragrafi 7 të Rregullores QRK Nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës se Paluajtshme Komunale, pas diskutimeve lidhur me pikën 4 të rendit të ditës: Shqyrtimi i Propozim vendimit për ndryshimin e vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale KRU Gjakova, e miratoi këtë:

## V e n d i m
## Për ndryshimin e vendimit për dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale

**1.** Ndryshohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Gjakovës 01 nr. 463102-22514/18 i datës 28.07.2018, për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale në pjesën e parcelës Nr. 4447-1 në Z.K Gjakovë J. Qytet, Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "KRU Gjakova", në sipërfaqe prej 32.89 ari.

**2.** Parcela me numër 4447-1 Zona Kadastrale Gjakovë jashtë Qytet, me sipërfaqe prej 32.89 ari të jepet në shfrytëzim Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "KRU Gjakova" sipërfaqen prej 22.14 ari.

**3.** Pjesa e parcelës me numër 4447-1 Zona Kadastrale Gjakovë jashtë Qytet, me sipërfaqe prej 22.14 ari të jepet në shfrytëzim Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "KRU Gjakova" pa kompensim.

**4.** Pjesa tjetër këtij vendimi 01 nr. 463102-22514/18 i datës 28.07.2018,mbetët në fuqi.

**5.** Obligohen organet e Administratës së Komunës së Gjakovës që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për realizimin e këtij vendimi.

**6.** Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

**7.Vendimi i' u dërgohet**:
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini.
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.
- Kompanisë Regjionale të Ujësjellësit "KRU Gjakova".
- Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës.
- Arkivit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
z. Anton Shala